



# Regullore per Certifikimin e Sistemeve te Menaxhimit Mjedisor

*Ne fuqi nga 1° Janar 2010*

RINA  
Via Corsica, 12 - 16128 Genova - Italia  
Tel. +39 01053851 - Fax: +39 0105351000  
[www.rina.org](http://www.rina.org)

---

Regullore teknike



## PERMBAJTJA

KAPITULLI 1	TE PERGJITHSHME .....	3
KAPITULLI 2	STANDARTI REFERUES / KERKESAT PER CERTIFIKIM.....	4
KAPITULLI 3	CERTIFIKIMI FILESTAR.....	6
KAPITULLI 4	MIREMBAJTJA E CERTIFIKIMIT .....	12
KAPITULLI 5	RICERTIFIKIMI I SISTEMIT TE MENAXHIMIT MJEDISOR.....	15
KAPITULLI 6	MENAXHIMI I CERTIFIKATAVE NE PERPUTHJE .....	17
KAPITULLI 7	MODIFIKIMI I CERTIFIKIMEVE DHE KOMINIKIMI I NDRYSHIMEVE.....	18
KAPITULLI 8	PROCEDURA SPECIFIKE PER SHOQERI SHUME FILIALESHE .....	19
KAPITULLI 9	TRASFERIMI I CERTIFIKATAVE TE AKREDITUARA.....	21
KAPITULLI 10	PEZULLIMI, RIVENDOSJA DHE HEQJA E CERTIFIKIMIT .....	22
KAPITULLI 11	DOREHEQJA NGA CERTIFIKIMI.....	24
KAPITULLI 12	KUSHTET KONTRAKTUALE .....	24



## KAPITULLI 1 TE PERGJITHSHME

### 1.1

Ne kete Rregullore jane percaktuar procedurat e aplikuar nga RINA per certifikimin e Sistemeve te Menaxhimit Mjedisor (SGA) dhe formalitetet e duhura, per marrjen, mbajtjen dhe perdorimin, si dhe per pezullimin dhe heqjen e certifikimit te dhene.

Per ceshtje te cilat nuk permbahen ne kete dokument, ju mund te referoheni ne "KUSHTE TE PERGJITHSHME TE KONTRATES PER CERTIFIKIMIN E SISTEMEVE, PRODUKTEVE DHE PERSONELIT", qe mund ta shkarkoni nga faqja e internetit [www.rina.org](http://www.rina.org).

### 1.2

RINA leshon kete certifikate Shoqerive ne te cilat sistemi i Menaxhimit Mjedisor eshte njohur ne perputhje me te gjitha kushtet e parashikuara nga Standarti.

ISO 14001:2004

Per me teper, me kerkese, RINA mund te kryeje kontrole te Sistemit te Menaxhimit Mjedisor ne marreveshje me dokumente te tjera ligjore te referuara ( per shembull Rregullorja EMAS, EPD) dhe, ne kete rast, leshon certifikimin perkates. Per raste te tilla duhet te merren ne konsiderate edhe Rregulloret specifike/udhezuese te RINA-s.

### 1.3

Certifikimi eshte i hapur per te gjitha Shoqerite dhe nuk eshte i kushtezuar nga pjesmarrja ose jo e tyre ne Grupe Shoqerish me te medha.

Per aktivitetin certifikues RINA aplikon te njejtat tarifa ne fuqi, duke garantuar barazine dhe njetrajtshmerine e aplikimit. RINA ne menyre legjitime refuzon kerkesat per certifikim nga Shoqeri te tilla te cilat kane qene subjekt, apo aktivitetet dhe produktet e tyre kane qene subjekt i kufizimeve, pezullimeve, apo bllokimeve nga ana e ndonje autoriteti Publik.

### 1.4

Certifikimi i leshuar nga RINA i jepet ekskluzivisht Shoqerise, ku termi Shoqeri nenkupton nje grup, organizate, ndermarrje, ent apo institucion, ose pjese te tyre apo kombinime, ne forme te bashkuar ose jo, publike ose private, qe kane strukturen e tyre funksionale dhe administrative.

Per Shoqerite qe kane me shume se nje njesi operative, vetem nje nga keto njesi mund te quhet si Shoqeri.

**1.5**

Procedurat e perfshira ne kete Rregullore aplikohen edhe kur certifikimi i Sistemit te Menaxhimit Mjedisor eshte kerkuar ne aplikimin e Rregullave per klasifikim nga RINA apo nga aplikime te tjera ligjore te Shoqerise; ne raste te tilla cdo kerkese shtese duhet te perfsihet e te perputhet me Sistemin e Menaxhimit Mjedisor.

**1.6**

Organi garant i certifikimeve te leshuara nga RINA (Organi i Akreditimit) mund te kerkoje pjesmarrjen e vezhguesve te tij ne kontrollin e kryera nga vete RINA, ne menyre qe te siguroje qe format e kontrollit te ushtruara nga RINA te jene ne perputhje me standartet perkatese. Pjesmarrja e ketyre vezhguesve vendoset paraprakisht midis RINA-s dhe Shoqerise. Nese Shoqeria nuk lejon pjesmarrjen e ketyre vezhguesve atehere vlefshmeria e certifikates pezullohet.

**1.7**

Terminologjia e perdorur ne kete Rregullore eshte sipas standartit ISO 14001:2004 dhe UNI CEI EN ISO/IEC 17000:2005.

**KAPITULLI 2  
STANDARTI REFERUES / KERKESAT PER CERTIFIKIM****2.1**

Per marrjen e certifikimit nga ana e RINA-s, nje Sistem Menaxhimi Mjedisor duhet te plotesoje fillimisht e me pas kerkesat sipas standartit ISO 14001- 2004 dhe ato te percaktuara ne pikat e ketij Kapitulli, si edhe elemente te tjere shtese te parashikuar nga Organi i Akreditimit (Shembull: Dokumenti Sincert "RT-09" per leshimin e certifikimit te Sistemit te Menaxhimit Mjedisor ne Itali me akreditimin Sincert).

Pergjate aktiviteteteve te tyre te akreditimit, ne fakt, RINA duhet ti permbahet dokumentave te percaktuara referuese te leshuara nga vete Organi i Akreditimit. Keto dokumenta mund te gjenden duke kontaktuar RINA-n ose direkt Organin e Akreditimit (duke u konsultuar ne faqen perkatese te internetit pershembull).

**2.2**

Ne vecanti, per marrjen e certifikimit te Sistemit te Menaxhimit Mjedisor, Shoqeria duhet:



2.2.1 Te kete kryer paraprakisht nje analize mjedisore te filialit/eve qe perfshijne:

- Nje pershkrim te llojit te aktivitetit te kryer ne filial/e per te cilin eshte bere kerkesa per certifikim te Sistemit te Menaxhimit Mjedisor;
- Nje identifikim te aspekteve mjedisore qe pajtohen me kete aktivitet dhe impaktet perkatese
- 

2.2.2 Te zoterojne nje Manual qe :

- percakton fushen e aplikimit te Sistemit te Menaxhimit Mjedisor, pershkruan elementet kryesore dhe nderveprimet e tyre, duke mbajtur te dokumentuara procedurat perkatese;
- merr ne konsiderate kerkesat e Standartit dhe jep nje pershkrim, shkurtimisht, te burimeve dhe te procedurave qe perdoren per te siguruar perputhjen e ketyre kerkesave;
- te permbaje nje pershkrim te drejte te funksionimit te Shoqerise
- 

2.2.3 Duhet te kete krijuar dhe mbajtur aktiv nje Sistem te Menaxhimit Mjedisor ne perputhje me standartin ISO 14001:2004.

Sistemi i Menaxhimit Mjedisor quhet plotesisht operativ kur :

- eshte aplikuar per te pakten tre muaj,
- sistemi i kontrollit te brendshem eshte plotesisht aktiv dhe mund te demostroje efikasitetin e tij,
- eshte zhvilluar dhe dokumentuar te pakten nje ekzaminim i ketij sistemi nga Drejtoria,
- jane vleresuar dhe identifikuar aspektet mjedisore te rendesishem;
- 
- jane stabilizuar e dokumentuar objektivat dhe programet mjedisore perkates;
- jane kryer dhe regjistruar monitorime te impakteve mjedisore dhe kontrole te aktivitetit ne pajtim me to;
- jane kryer veprime per permiresimin e vazhdueshem dhe parashikimin e ndotjes.

## 2.3

Kerkesat e percaktuara ne piken 2.2 jane verifikuar nga RINA, nepermjet nje procesi kontrolli fillestar i perbere nga dy nivele:

- Niveli i kontrollit 1, i cili mund te kryhet:
  - pjeserisht ne zyre dhe pjeserisht ne vendndodhjen (filialin) e Shoqerise



ose  
- plotesisht ne vendndodhjen (filialin) e Shoqerise

- Niveli i kontrollit 2 – RINA kryen kontrollin ne vendndodhje (filial).

Vecorite e kontrollit fillestar jane pershkruar ne kapitullin pasardhes

## KAPITULLI 3 CERTIFIKIMI FILLESTAR

### 3.1

Shoqerite qe deshirojne te marrin certifikimin e Sistemit te tyre te Menaxhimit Mjedisor, duhet ti paraqesin RINA-s te dhenat kryesore te Shoqerise dhe aktiviteve te ndryshme te zhvilluara prej tyre, si dhe vendndodhjen, duke derguar modulim perkates "Pyetesor informues" te plotesuar ne te gjithe pjeset e tij, i cili gjendet ne adresen e internetit [www.rina.org](http://www.rina.org), ne baze te te cilave RINA formulon nje oferte ekonomike.

Vecanerisht, Shoqeria duhet ti komunikojte RINA-s:

- informacione qe permbajne te gjitha proceset e kryera jashte, te perdorura nga Shoqeria qe mund te ndikojne permbushjen e kerkesave;
- numrin e filialeve te perhershme dhe te perkohshme objekt i certifikimit dhe aktiviteve te tjera te zhvilluara prej tyre;
- aktiviteve/filiale te mundshme te perjashtuara nga fusha e aplikimit te Sistemit te Menaxhimit Mjedisor me qellim verifikimin e pranimet te ketyre perjashtimeve

Keto informacione kerkohen me qellim qe te verifikojne paraprakisht aplikimin e disa kerkesave te standartit dhe te parapregatisin nje oferte ekonomike te pershtatshme.

Shoqerite, ne rastet e pranimet te ofertes ekonomike, formulojne kerkesen per certifikim duke i derguar RINA-s modulim specifik bashkelidhur ofertes, duke percaktuar standartin referues dhe, ne kete rast, dokumente te tjera ligjore perkatese, sipas te cilave eshte kerkuar certifikimi.

Me marrjen e kerkeses per certifikim dhe dokumenteve te tjera bashkelidhur, e pasi eshte siguruar qe ato jane te plota, RINA i dergon Shoqerise konfirmimin e pranimet te regjistrimit per kete kerkesa.

Kerkesa e Shoqerise, ne te cilen jane shprehur specifikat e kesaj Rregulloreje, dhe pranimin relativ nga ana e RINA-s, formalizojne marredhenien kontraktuale midis RINA-s dhe Shoqerise si dhe aplikueshmerine e kesaj Rregulloreje.

Kontrata e nenshkruar midis RINA-s dhe Shoqerise perfshin:



- kontrollin fillestar te perbere nga dy faza dhe leshimin e certifikates;
- kontrole te metejshme mbikeqyrese dhe ricertifikuese;
- sherbime te tjera shtese te percaktuara ne oferte.

RINA i komunikon Shoqerise emrat e teknikeve te ngarkuar per kryerjen e kontrollit te fazes 1 dhe te kontrollit te fazes 2 ; Shoqeria mund te beje verejtje mbi emerimin e ketyre teknikeve, duke justifikuar arsyet.

Pergjate kontrollit fillestar Shoqeria duhet te tregojte qe Sistemi i Menaxhimit eshte plotesisht operues nga te pakten tre muaj dhe qe ka aplikuar ne menyre efektive vete Sistemin dhe procedurat e tij perkatese te dokumentuara.

### 3.2

Se bashku me kerkesen per certifikim, dhe pasueset e saj, Shoqeria duhet te paraqese tek RINA dokumentacionin e meposhtem:

- konkluzionet perkatese te analizes paraprake te filialit/eve perfshire dhe sistemimin e **lay-out** filialit/eve;
- manualin e menaxhimit mjedisor qe pershkruan Politiken Mjedisore, Objektivat e Programit/eve Mjedisore dhe te Sistemit te Menaxhimit mjedisor te Shoqerise (rishikimin e fundit te vlefshem);
- hartën e oganizimit te Shoqerise;
- listen e procedurave te brendshme te rendesishme me qellim menaxhimit mjedisor;
- listen e autorizimeve te natyres mjedisore qe zoteron Shoqeria dhe listen e permbushjeve mjedisore te aplikuara nga Shoqeria duke plotesuar modulën "Lista e autorizimeve dhe permbushjeve mjedisore" (bashkelidhur ofertes) apo dhenien e dokumentacionit ekuivalent;
- kopjen e certifikates se regjistrimit prane Dhomes se Tregtise apo dokumentin e barazvlefshem, i cili evidenton ekzistencen e Shoqerise dhe te aktivitetit qe ajo kryen;
- listen e kantiereve operues, duke pershkruar aktivitetet qe kryhen atje, nese aplikohen;

RINA mund te kerkoje me gjykimin e saj per shqyrtim, edhe dokumente te tjera pervec atyre te mesiperm, te cilat konsiderohen te rendesishem ne vleresimin e Sistemit te Menaxhimit Mjedisor.

Dokumentacioni i mesiperm vleresohet nga RINA per perputhjen me standartin referues dhe me kerkesat e kesaj Rregulloreje.



Rezultati i kontrollit i komunikohet kerkuesit duke i derguar nje kopje te raportit te fazes 1- rezultat I dokumentuar (nese ky eshte kryer nga zyrat e RINA-s); gjetje te mundshme te rendesishme ne dokumentacion e te konsideruara kritike duhet te zgjidhen nga Shoqeria, duke kenaqur RINA-n, perpara vazhdimet te te gjithë procesit te certifikimit

Dokumentacioni sa me siper, ne pergjithesi mbahet dhe eshte ne perdorim te arkivit nga RINA.

Nese kontrolli I fazes 1 kryhet plotesisht ne filial, rezultati I kontrollit te dokumentacionit gjithashtu vihet ne raportin e kontrollit te fazes 1 – kontroll I documentacionit dhe I dorezohet Shoqerise se bashku me raportin e fazes 1 “mbi-filial” si ne piken 3.3.

### 3.3

Kontrolli I fazes 1 “mbi-filial” i Sistemit te Menaxhimit Mjedisor kryhet pergjithesisht ne filialin/et e Shoqerise, pervec rasteve te vecanta.

Perfundimi i ketij kontrolli eshte:

analizimi I ketij Sistemi duke mbledhur informacionet e nevojshme ne lidhje me fushen e aplikimit te Sistemit te Menaxhimit, proceset dhe filialet e Shoqerise, me rregullatoret e aspektet ligjore perkatese.

planifikimi I fazes 2 te kontrollit duke rikontrolluar burimet e parashikuara per kryerjen e ketij kontrolli dhe duke rene dakord me Shoqerine per detajet e kontrollit te fazes 2

Pergjate kontrollit te fazes1 “mbi-filial”, tekniket e kualifikuar ngal RINA, mund te kryejne “mbi filial” edhe inspektime dhe intervista me personelin e Shoqerise, duke verifikuar qe:

- a) dokumentacioni I Sistemit te menaxhimit Mjedisor, perfshire procedurat, ploteson te gjithë kerkesat e standartit;
- b) eshte kryer nje cikel I plote kontrolli I shtrire ne te gjithë filialet dhe kontrolli perkates ne drejtori;
- c) Shoqeria ka dokumentuar vleresimin e aspekteve mjedisore te rendesishem dhe besueshmerine e ketyre vleresimeve ne lidhje me llojin e Shoqerise;
- d) Shoqeria disponon te gjithë autorizimet e duhura me natyre mjedisore, ne lidhje me aktivitetin e saj, te cilat jane te vlefshme;
- e) qe Shoqeria rezulton konform permushjes se dokumentave si ne piken d) ashtu edhe ne permbushjen e kerkesave nga legjislacioni mjedisor dhe aplikimet e tyre.

Ne rast se per sa u specifikua ne piken e mesiperme d) dhe e) nuk plotesohen atehere referohuni per sa qartesohet ne piken 3.6.

Ne perfundim te kontrollit te fazes1 I dorezohet Shoqerise kopja e raportit te kontrollit te fazes 1 “mbi-filial”, ne te cilin shkruhen midis te tjerash gjetjet e mundshme me te rendesishme, duke perfshire ato qe klasifikohen mosperputhje/verejtje pergjate kontrollit te fazes 2.

Veprimet e ndermarra nga Shoqeria per eliminimin e ketyre gjetjeve jane, pergjithesisht, verifikim pergjate kontrollit te fazes 2 qe tregohen ne piken 3.4



Prezenca e gjetjeve te mundshme te rendesishme, sipas gjykimit te teknikeve qe kane kryer kontrollin, do te kerkoje zgjidhjen e plote te tyre, para kontrollit te fazes 2 prane Shoqerise. Kontrolli I fazes 2 duhet te kryhet brenda nje kohe prej 6 muajsh nga perfundimi I kontrollit te fazes 1 dhe nese kalon kjo kohe duhet perseritur kontrolli I fazes 1. Ne raste te vecanta RINA mund te vleresoje te zgjase kete kohe ne 12 muaj.

### 3.4

Faza 2 e kontrollit prane Shoqerise kryhet me qellim qe te verifikohet zbatimi me korrektesi i Sistemit te Menaxhimit Mjedisor.

Perpara fillimit te kontrollit te fazes 2, RINA dergon nje plan kontrolli prane filialit/eve te Shoqerise duke dhene nje perskrim te detajuar te aktiviteteve dhe kerkesave per fillimin e kontrollit.

Nese Shoqeria kryen aktivitetet e saj ne me shume se nj filial, kontrolli do te kryhet sipas kriterëve te vendosura nga RINA qe i jane komunikuar Shoqerise.

Ky kontroll kryhet nga teknike te kualifikuar te RINA-s mbi bazen e raportit te kontrollit te fazes 1 dhe duke u ndjekur nga dokumentacioni me i fundit i pergatitur nga Shoqeria:

- manuali i Sistemit te Menaxhimit Mjedisor,
- pyetesori informues i plotesuar nga Shoqeria,
- lista e procedurave te brendshme,
- procedura menaxhimi dhe dokumente te tjera te Sistemit te Menaxhimit Mjedisor.
- Analiza Paraprake Mjedisore.

Kryesisht kontrolli i fazes 2 konsiston ne:

- nje mbledhje fillestare me tekniket e Shoqerise ne menyre qe te bien dakord e te konfirmojne objektivat dhe metodat e kontrollit, te percaktuara ne planin e parashikuar nga ai;
- verifikimin e zbatimit me efektivitet te veprimeve perkatese korrigjuese te gjetjeve te rendesishme pergjate fazes 1 te kontrollit;
- nje inspektim te Filialit/eve Prodhues/e te Shoqerise per te verifikuar perputhjen e Sistemit te Menaxhimit Mjedisor me dokumentet referuese dhe zbatimin e plote te tyre; ne vijim te ketyre inspektimeve do te jene midis te tjerash, qartesime mbi impiantet dhe bisedime me personelin e Shoqerise qe perfshihet ne Sistemin e Menaxhimit Mjedisor;
- nje mbledhje permbyltese per te shpjeguar rezultatet e kontrollit.

### 3.5



Ne fund te kontrollit te fazes 2 i jepet Shoqerise kopja e raportit te kontrollit, ne te cilin shkruhen midis te tjerash mosperputhjet e mundshme (tipi "A" i gjetur), verejtje (tipi "B" i gjetur) mbi aplikimin e Sistemit te Menaxhimit Mjedisor dhe rekomandimet (tipi "C" i gjetur) e duhura.

Shoqeria mund te shenoje komentet apo rezervat e saj te mundshme, ne lidhje me verejtjet e shprehura nga tekniket e RINA-s, ne nje hapesire perkatese te raportit te kontrollit.

Permbajtja e plote e raportit konfirmohet me pas nga RINA nepermjet komunikimi te shkruar.

Ne mungese te dokumentacionit te shkruar nga ana e RINA-s, raporti mund te quhet i konfirmuar pas tre dite pune nga dorezimi i tij tek Shoqeria.

Shoqeria, pasi ka analizuar arsyet e mundshme te mosperputhjes dhe/ose verejtjet e bera ne raportin me siper, duhet te informoje RINA-n, brenda dates se treguar ne kete raport, per propozimet e saj mbi trajtimet e nevojshme te mosperputhjeve dhe/ose verejtjeve po ashtu dhe veprimet e duhura korrigjuese si edhe kohet e parashikuara per zbatimin e tyre.

Eshte parashikuar mundesia e shfrytezimit te "Member Area" ne faqen e internetit te RINA-s ([www.rina.org](http://www.rina.org)) per dergimin e propozimeve te trajtimit dhe veprimeve korrigjuese, te cilat pranoen me tej nga RINA. Shoqeria, ne fakt, mund te propozoje trajtime te mundshme dhe veprime korrigjuese duke plotesuar formularet perkates direkt ne "Member Area" ne faqen e internetit RINA ([www.rina.org](http://www.rina.org)).<sup>1</sup>

RINA do te njoftoje Shoqerine me shkrim per pranimin e propozimeve dhe per afatet e zbatimit te tyre.

### 3.6

Ne mungese te autorizimeve, apo dokumentave te njevlere shme, ne fushen mjedisore, te kerkuara nga legjislacioni ne fuqi, procesi i certifikimit pezullohet, derisa Shoqeria te tregojte te qe:

- ka paraqitur kerkesen e plote dhe korrekte per autorizimin nga te pakten gjashte muaj;
- ka kryer me korrektesi te gjitha hapat e parashikuara per rrugen autorizative;
- ka kerkuar me kembengulje dhe ne menyre te vazhduar e te dokumentuar Entit Publik te pocasem per leshimin e autorizimit;
- ka respektuar gjithashtu, nese ka, kufijte e parashikuara nga ligji.

---

<sup>1</sup> Ne rast te pamundesise se hyrjes ne Internet, Shoqeria mund te plotesoje formularet ne leter dhe ti dergoje prane zyres kompetente te RINA-s.



Ne rast te paqartesive te rendesishme pergjate procesit te kontrollit, qe lidhen me mosplotesimin e kerkesave te forta ligjore ne fushen mjedisore<sup>2</sup>, procesi i certifikimit, pavec rasteve te vecanta, pezullohet deri kur Shoqeria te plotesoje keto kerkesa.

### 3.7

Ne rast te mosperputhjeve<sup>3</sup> procesi i certifikimit pezullohet; ne rast te verejtjeve numri i te cilave nga gjykimi i grupit te kontrollit eshte i tille qe ve ne rrezik efikasitetin e ketij Sistemi, procesi i certifikimit gjithashtu pezullohet.

Ne raste te tilla, brenda tre muajsh, RINA duhet te kryeje nje kontroll suplementar perfundimtar per te verifikuar efikasitetin e trajtimeve dhe propozimeve te veprimeve korigjuese; nese perfundimi i ketij kontrolli eshte pozitiv atehere procesi i certifikimit rifillon.

Kontrolli suplementar mund te kryhet ne filial ose mbi bazen dokumentale sipas llojit te veprimeve korigjuese per tu verifikuar nga gjykimi i grupit te kontrollit.

Te gjitha shpenzimet perkatese te ketij kontrolli suplementar rrjedhoje e perkujdesjes se Sistemit te Menaxhimit Mjedisor konsiderohen ne ngarkim te Shoqerise.

Nese kalohet periudha e mesiperme, Sistemi i Menaxhimit Mjedisor i Shoqerise do ti nenshtrohet nje riezaminimi te plote brenda nje kohe prej gjashte muajsh nga data e perfundimit te kontrollit te fazes 2.

Kalimin e kesaj periudhe gjashtemuajore pa konkluzione pozitive te vleresimit, RINA do te konsideroje te mbyllur praktiken e certifikimit, duke adebituar kohen dhe shpenzimet e kryera deri ne kete moment. Ne raste te tilla Shoqeri qe deshirojne te vazhdojne me certifikimin nga RINA duhet te paraqesin nje kerkesa te re dhe te perserisin te gjitha procedurat e certifikimit.

Ne raste te vecanta, limiti i kohes se mesiperme mund te modifikohet me kerkesen e Shoqerise, nese konsiderohet nga gjykimi i RINA-s.

---

<sup>2</sup> Nenkuptohen me kerkesa te forta ligjore:

- Kufijte dhe/ose dispozitat ligjore;
- Kufijte dhe/ose pershkrimet e dhena mbi autorizimet dhe mbi dokumente te tjere pershkrues etj.

<sup>3</sup> Nenkuptohen mosperputhje :

- mungesa e plote e konsiderimit te nje apo me shume kerkesave te standartit referues
- mungesa e respektimit te nje apo me shume kerkesave te kesaj Rregulloreje,
- nje situat qe mund te provokojte dergimin e nje produkti i cili nuk perputhet dhe nuk i pergjigjet ligjeve ne fuqi,
- nje situat e tille qe provokon nje mungese te madhe te Sistemit te Menaxhimit, apo qe zvogelon kapacitetin per sigurimin e kontrollit te procesit te produktit/sherbimit.



### 3.8

Pas nje kompletimi te kenaqshem te vleresimit dhe vlefshmerise, nga Komiteti perkates i RINA-s, leshohet, nje Certificate ne perputhje e Sistemit te Menaxhimit Mjedisor, (fotokopja e te cilit eshte gatshme ne faqen e internetit [www.rina.org](http://www.rina.org)) me kohezgjatje per tre vjet.

Vlefshmeria e certifikates varet nga rezultati i kontroleve vezhguese pasuese vjetore dhe nga ricertifikimi trevjecar i Sistemit te Menaxhimit Mjedisor.

Periudha dhe shtrirja e kontroleve te metejshme per mirembajtjen e certifikimit jane vendosur nga RINA duke u bazuar ne ndjekjen hap pas hapi te nje kontrolli trevjecar te programuar, i cili i eshte derguar Shoqerise.

Per detaje mbi administrimin dhe vlefshmerine e certifikatave te perputhshmerise te leshuara nga RINA shihni kapitullin pasardhes 6.

## **KAPITULLI 4 MIREMBAJTJA E CERTIFIKIMIT**

### 4.1

Shoqeria duhet te siguroje qe Sistemii i saj i Menaxhimit Mjedisor vazhdon te jete ne perputhje me Standartin Referues.

### 4.2

Shoqeria , mes te tjerash duhet te mbaje regjistrimet perkatese te:

- aspekteve/impakteve mjedisore;
- incidente/emergjenca mjedisore te ndodhura ne filial/e dhe ndodhi te tjera te mundshme te cilat fuqimisht do te kene efekte negative ne mjedis;
- reklamime te ndryshme te marra perkatesisht nga impaktet mjedisore te produkteve te tyre

dhe duhet te vere ne dispozicion te RINA-s se bashku me veprimet korigjuese te ndermarra gjate kontroleve periodike.

Shoqeria duhet te mbaje te informuar RINA-n rreth ekzistences se verejtjeve/sinjalizimeve te mundshme te dhena nga autoritete kombetare ose rajonale per nje kontroll mjedisor apo situata te mosperputhjeve legjislativ per te gjitha aktivitetet e zhvilluara nga shoqeria pavaresisht nga fusha e aplikimit te Sistemit te Menaxhimit Mjedisor.



### 4.3

RINA kryen kontrole periodike mbi Sistemin e Menaxhimit Mjedisor ne menyre qe te vleresoje cfare ka mbetur pa u plotesuar nga kerkesat e Standartit Referues.

Kontrollet per mirembajtjen e certifikimit ndahen ne dy tipe:

- kontroll mbikeqyres, qe ne pergjithesi kryhet te pakten nje here ne vit.
- Kryhet nje vleresim I pjesshem mbi Sistemin e Menaxhimit Mjedisor sipas programit te percaktuar ketu ne piken 3.8 te cilin e zoteron Shoqeria.
- kontroll ricertifikimi (shiko kapitullin 5);
- Sistemi I Menaxhimit Mjedisor duhet te rivleresohet plotesisht cdo tre vjet ;

### 4.4

Kontrollet mbikeqyrese kryhen prane filialit/eve te Shoqerise, sipas nje programi trevjecar qe lejon te verifikoje, pergjate tre viteve, te pakten nje here, cdo pike perkatese te pershkrimeve qe permban Standarti Referues sipas te cilit Sistemi i Menaxhimit Mjedisor eshte certifikuar.

Pergjate kontroleve mbikeqyrese do te merren ne konsiderate aspektet e meposhtme:

- a) kontrolli i brendshem dhe shqyrtimi nga ana e Drejtorise;
- b) nje shqyrtim i veprimeve te ndermarra sipas mosperputhjeve/verejtjeve te identifikuara pergjate kontrollit te meparshem;
- c) trajtimi i reklamimeve
- d) efikasiteti i sistemit te Menaxhimit ne lidhje me arritjen e objektivave;
- e) progresi i aktiviteve te planifikuara qe con ne permiresim te vazhdueshem;
- f) kontrolli operativ i vazhdueshem;
- g) rishqyrtimi i cdo ndryshimi.

Detajet e aktiviteve dhe instruksionet per kryerjen e kontrollit mbikeqyres ne filial/e pershkruben ne planin e kontrollit mbikeqyres te cilin RINA ja con Shoqerise perpara se te kryeje kete kontroll.

### 4.5

Duhet te kryhet te pakten nje kontroll mbikeqyres ne periudhen e jo me shume se 12 muajve, dhe data ne te cilin do te kryhet ky kontroll percaktohet ne planin e kontrollit trevjecar qe e zoteron Shoqeria.

Ky program mund te modifikohet nga RINA mbi bazen e kontolleve te meparshem mbikeqyres.



Nese limitet e kohes se kontrollit mbikeqyres jane zgjatur per arsye te justifikuara, duhet te bihet dakord paraprakisht me RINA-n dhe kjo duhet rifitohet ne kontrollin e pare pasardhes.

Ne cdo rast data e kontrollit te pare mbikeqyres, pasardhes i certifikimit fillestar duhet te fiksohet brenda 12 muajve nga data perfundimtare e kontrollit te fazes 2.

#### 4.6

RINA rezervon te drejten e kryerjes se kontrollit pa lajmerim, ne krahasim me kontrollet e parashikuara ne programin trevjecar, prane Shoqerise:

- ne rastin e ardhjes se reklamimeve ose sinjalizimeve, qe konsiderohen domethenese, qe lidhen me mospermbushjen e Sistemit te Menaxhimit Mjedisor me kerkesat e standartit referues, dhe te kesaj Rregulloreje.
- ne lidhje me ndryshime te vendosura ne Shoqeri.
- Shoqerive te cilave u eshte pezulluar certifikimi.

Ne rast refuzimi, pa arsye te justifikuara, nga ana e Shoqerise, RINA mund te vendose pezullimin/heqjen e certifikimit.

Ne rastin ku reklamimet dhe sinjalizimet jane te justifikuara nga RINA, kostoja e kontroleve shtese do te mbulohe nga Shoqeria.

#### 4.7

Te dhenat e kontroleve mbikeqyrese jane ne marreveshje me Shoqerine me pershtatshmeri te avancuar dhe kjo konfirmohet zyrtarisht me ane te nje komunikimi te shkruar.

Emrat e teknikeve te kualifikuar qe do te kryejne kontrollin i jane komunikuar paraprakisht nga RINA Shoqerise, e cila mund te beje verejtje per emrat e tyre, duke justifikuar arsyet.

#### 4.8

Per menyren e komunikimit te rezultateve te kontrollit, referohuni me siper ne piken 3.5.

Vlefshmeria e certifikates konfirmohet pas rezultatit pozitiv te kontrollit mbikeqyres.

#### 4.9

Prania e mosperputhjeve apo verejtjeve ne te cilat shumica nga gjykimi i grupit te kontrollit eshte e tille qe paragjykon funksionimin korrekt te Sistemit, Shoqeria do ti nenshtrohet nje kontrolli shtese brenda kohes se vendosur nga RINA, ne lidhje me rendesine e vete mosperputhjeve/verejtjeve e, megjithate, jo per me shume se tre muaj nga mbarimi i kontrollit mbikeqyres perfundimtar per verifikimin e efikasitetit te trajtimeve dhe veprimeve korigjuese te propozuara.

Ne rast se mosperputhjet nuk jane zgjidhur brenda kohes se caktuar apo verejtjet e rendesishme jane te tilla qe nuk sigurojne kontrollin e aspekteve/impakteve mjedisore dhe



ligjet aplikuese, RINA mund te pezulloje certifikimin deri kur keto mosperputhje/verejtje nuk jane korrigjuar ne marreveshje me sa eshte parashikuar ne piken 10.1.

Te gjitha shpenzimet relative te kontrolleve shtese si rrjedhoje e mangesive ne Sistemin e Menaxhimit Mjedisor do ti ngarkohen Shoqerise.

## **KAPITULLI 5 RICERTIFIKIMI**

### **5.1**

Ne rastin e kontrollit per ricertifikim te Sistemit te Menaxhimit Mjedisor, te parashikuar cdo tre vjet, Shoqeria duhet te kontaktoje me RINA-n, rreth tre muaj me pare nga data e parashikuar ne programin e kontrollit trevjecar, te cilin tashme e ka, dhe te dergoje nje kopje te fundit te plotesuar ne te gjithe pjeset te Pyetesorit Informues (qe gjendet te adresen [www.rina.org](http://www.rina.org)) ne menyre qe te planifikoje aktivitetin e te bien dakord per daten e kryerjes se kontrollit te ricertifikimit.

Data e kryerjes se kontrollit te ricertifikimit, e vendosur ne marreveshje me Shoqerine paraprakisht, konfirmohet zyrtarisht nepermjet nje komunikimi te shkruar.

Emertimi i teknikeve te kualifikuar te ngarkuar per kryerjen e kontrollit i eshte komunikuar paraprakisht nga Rina Shoqerise, e cila mund te beje verejtje mbi kete emertim, duke justifikuar arsyet.

### **5.2**

Kontrulli i ricertifikimit ka si qellim, te konfirmimoje mirembajtjen e perputhshmerise e te efikasitetit te Sistemit te Menaxhimit ne teresine e tij dhe bazohet kryesisht ne nje kontroll ne filial, e qe si rregull permban te njejtat kriteret e kontrollit te fazes 2.

Ne vecanti, kontrulli i ricertifikimit permban nje kontroll ne filial qe merr ne konsiderate, midis te tjerave aspektet e meposhtme:

- a) efikasitetin e sistemit te menaxhimit ne teresine e tij, ne driten e ndryshimeve te brendshme e te jashtme, vazhdimesine e kompetences dhe aplikueshmerise per fushen e aplikimit te certifikimit;
- b) detyrimin e mbajtjes se efikasitetit dhe permiresimit te sistemit te menaxhimit me qellim permiresimin ne pergjithesi;
- c) nese operativiteti i sistemit te menaxhimit kontribuon rrjedhimisht ne politikat dhe objektivat e shoqerise.

Detajet e aktiviteve dhe instruksionet per kryerjen e kontrollit te ricertifikimit ne filial/e jane pershkruar ne planin e ricertifikimit, te cilin RINA ja dergon Shoqerise perpara kryerjes se ketij kontrolli.



### 5.3

Si pasoje e rezultatit pozitiv te kontrollit te ricertifikimit, grupi i kontrollit i paraqet RINA-s propozimin e ricertifikimit te Shoqerise me qellim rilesimin e certifikates ne perputhje.

Certifikata ne perputhje rilesohet nga RINA si pasoje e rezultatit pozitiv te kontrollit te mesiperm propozuar Shoqerise.

Konfirmimi i aprovimit te ricertifikimit me leshimin e certifikates perkatese nga ana e RINA-s i dergohet per regjistrim Shoqerise.

Per detajet mbi menaxhimin dhe vlefshmerine e certifikates ne perputhje te rilesuar nga RINA shihni ne kapitullin 6.

### 5.4

Procedura e ricertifikimit duhet te perfundoje me sukses perpara dates se skadences se certifikimit te treguar ne certifikate, date e cila nuk mund te shtyhet nga RINA

Rjedhimisht kontrolli i ricertifikimit duhet te perfundoje me sukses ne kohen e duhur, ne menyre qe ti lejoje RINA-s aprovimin e ricertifikimit te propozuar dhe rilesimin e certifikates perkatese brenda dates se mesiperme (te pakten nje muaj perpara dates se skadences te vendosur ne certifikate).

Nese Shoqeria nuk i permbahet afateve te mesiperme dhe nuk arrin te fitoje rilesimin e certifikates brenda dates se skadences, certifikata do te quhet e skaduar duke filluar nga nje dite me pas nga data e skadences e treguar ne certifikate.

Shoqerite qe do te marrin certifikimin e ardhshem, pas skadimit te certifikates, duhet te paraqesin nje aplikim te ri dhe pergjithesisht te perserisin te gjitha proceduren e plote te certifikimit.

### 5.5

Prania e mosperputhjeve apo verejtjeve ne te cilat shumica nga gjykimi i grupit te kontrollit eshte e tille qe paragjykon funksionimin korrekt te Sistemit, Shoqeria duhet domosdoshmerisht te aplikojte, ne menyre efikase, trajtimet dhe veprimet korigjuese perkatese perpara dates se skadences se certifikates perputhese.

Kjo do te thote qe Shoqeria duhet te kryeje nje kontroll shtese per te verifikuar mbylljen e te quajturave mosperputhje/verejtje ne kohen e duhur per leshimin e certifikates pasardhese.

Kohet e percaktuara brenda te cilave RINA duhet te kryeje kontrollin shtese i komunikohen Shoqerise ne raportin e kontrollit te ricertifikimit.

K Kontrolli shtese, me qellim verifikimin e trajtimeve dhe veprimeve korigjuese te propozuara, mund te kryhet ne filial ose mbi bazen e dokumentacionit sipas llojit te veprimeve korigjuese per tu verifikuar nga gjykimi i grupit te kontrollit.

Te gjitha shpenzimet relative te kontroleve shtese si rrjedhoje e mangesive ne Sistemin e Menaxhimit Mjedisor do ti ngarkohen Shoqerise.



## KAPITULLI 6 MENAXHIMI I CERTIFIKATAVE NE PERPUTHJE

### 6.1

Certifikata ne perputhje e leshuar nga da RINA eshte e vlefshme per tre vjet duke filluar nga data e aprovimit te propozimit te certifikimit fillestar apo te ricertifikimit nga ana e RINA-s.

Ne certifikate shkruhen mes te tjerash, qartesime qe sjellin aktivite te mundshme te cilat jane prezente ne filialin/et objekt I certifikimit, por te perjashtuara nga fusha e aplikimit te Sistemit te Menaxhimit Mjedisor.

### 6.2

Nga momenti i leshimit te certifikates nga ana e RINA-s, nje kopje origjinale e vete programit perkates se kontrollit trevjecar i vihet ne dispozicion Shoqerise ne "Member Area" ne faqen e internetit RINA ([www.rina.org](http://www.rina.org)). Keshtu Shoqeria, mund te hyje dhe te shkarkoje dokumente e mesiperme, drejtperdrejt nga kjo zone e faqes se internetit te RINA-s.

Ne rast te pamundesise se hyrjes ne Internet, Shoqeria mund te kerkoje kopje origjinale ne leter prane zyres kompetente te RINA-s.

### 6.3

Vlefshmeria e certifikates, ne harkun trevjecar te vlefshmerise, varet nga rezultati i kontrolleve mbikeqyrese te metejshme.

Rezultati pozitiv i cdonjerit prej kontrolleve te ricertifikimit, sic eshte thene ne kapitullin e meparshem 5, eshte rilesimi i certifikates ne perputhje.

Vlefshmeria e certifikates mund te pezullohet, hiqet ose te mospranohet me marreveshje sic eshte parashikuar ne kapitullin 10 e 11.

RINA publikon dhe mban te apdetuara drejtperdrejt ne faqen e saj ne internet [www.rina.org](http://www.rina.org):

Regjistrin e Shoqerive te certifikuara;

Gjendjen aktuale te vlefshmerise se certifikatave te leshuara, duke percaktuar per cdo certifikate gjendjen: e vlefshme, pezulluar ose jo e vlefshme;

Kopje te certifikatave te vlefshme.

Me kerkese, RINA jep informacione mbi arsyet qe bejne te pavlefshme certifikaten.



## **KAPITULLI 7**

### **MODIFIKIMI I CERTIFIKIMEVE DHE KOMUNIKIMI I NDRYSHIMEVE**

#### **7.1**

Shoqeria qe ka marre certifikimin mund te kerkoje nje modifikim apo zgjatje te tij duke paraqitur nje kerkese te re certifikimi, te shoqeruar nga dokumentacioni me i fundit bashkengjitur, si tregohet ne piken 3.1. RINA ka te drejte te ekzaminoje rast pas rasti kerkesat dhe te vendose menytrat e vleresimit me qellim te nje certifikimi te ri, ne perputhje, sic eshte parashikuar ne "KUSHTET E PERGJITHSHME TE KONTRATES PER CERTIFIKIMIN E SISTEMEVE, PRODUKTEVE DHE PERSONELIT" sipas Standartit ISO 14001:2004.

#### **7.2**

Shoqeria duhet te informoje menjehere RINA-n per ndryshime te mundshme te kryera ne aspekte qe mund te influencojne ne kapacitetin e sistemit te menaxhimit, per te vazhduar ne permbushjen e kerkesave te standartit te perdorur per certifikim.

Keto kerkesa i perkasin, per shembull, varianteve relative:

- a) te gjendjes ligjore, tregetare, organizative ose pronesise;
- b) shoqerise dhe menaxhimit, (p.sh. menaxheret kyce dhe personeli teknik, procesi vendimtar);
- c) adresat e kontaktit dhe te filialeve;
- d) ne fushen e aplikimit te aktivitetit qe mbulon sistemi I menaxhimit I certifikuar;
- e) ne ndryshime domethenese te sistemit te menaxhimit dhe te proceseve;

Rina ka te drejte te kryeje kontrole te tjera ne Shoqeri ne rast se modifikimet e komunikuarane kane nje permbajtje vecanerisht domethenese, me qellim mirembajtjen e perputhshmerise te Sistemit te Menaxhimit Mjedisor me kerkesat e Standartit referues dhe kesaj Rregulloreje e te rishikoje kushtet ekonomike per modifikime te mundshme ne kontrate.

## **KAPITULLI 8**

### **PROCEDURA SPECIFIKE PER SHOQERI SHUMEFILIALESHE**

#### **8.1**

Nese nje Shoqeri operon ne disa filiale te perhershme dhe eshte kerkuar vetem nje certifikim, aktivitetet e kontrollit mund te kryhen ne nje zgjedhje te filialeve qe nenshtrohen per kontroll, nese:

Proceset ne te gjitha filialete jane thelbesisht i te njejtij lloj dhe zhvillohen me metoda e procedura te ngjashme. Ne rast te proceseve te ndryshme ne vende te ndryshme keto duhet te jene te lidhur (psh. Fabrikimi I perberesve elektronike ne nje vend, mbledhja e ketyre perberesve, e kryer nga e njejta Shoqeri ne vende te ndryshme)



Sistemi I menaxhimit te menaxhohet e administrohet ne nivel qendror dhe ti nenshtrohet nje kontrolli nga ana e drejtorise qendrore

Shoqeria, midis te tjerash, duhet te demostroje qe zyra qendrore ka vendosur nje sistem menaxhimi mjedisor ne perputhje me standartin referues dhe qe e gjithë Shoqeria ploteson kerkesat.

Vecanerisht, te pakten aktivitetet e meposhtme duhet te menaxhohen nga funksioni qendror i Shoqerise:

- vleresimi i nevojave te trajnimit;
- kontrolli i dokumentacionit dhe modifikimet e tij;
- kontrolli i Sistemit te Menaxhimit nga ana e drejtorise;
- reklamime nga ana e paleve te treta te interesuara;
- vleresimi i efektivitetit te veprimeve korrigjuese;
- planifikimi i zbatimit te kontrollit te brendshem dhe vleresimi i rezultateve te tyre;
- analiza mjedisore te filialeve
- modifikime te aspekteve dhe impakteve pjese e sistemit te menaxhimit mjedisor
- prania e kerkesave te ndryshme ligjore;

Perpara kontrollit fillestar nga ana e RINA-s, Shoqeria duhet te kete kryer nje kontroll te brendshem te cdo filiali dhe te kete verifikuar perputhjen e sistemit te saj te menaxhimit me standartin referues.

## 8.2

Nese Shoqeria i respekton kushtet e mesiperme, RINA megjithate kontrollon mundesite ne modelin e nje filiali dhe vendos te kufizojë modelin ne rastet e meposhtme:

- kerkesa qe lidhen me faktore te ndryshem lokale;
- sektore apo aktivite te perfshira ne fushen e aplikimit;
- numri i filialeve i pershtatshem per nje kontroll shumefilialesh;
- variacione ne permbushjen lokale te sistemit te menaxhimit, si domosdoshmeri e perseritjes se shpeshte ne perdorim, ne lidhje me sistemin e menaxhimit, plane te cilat kane objekt aktivite te ndryshme apo sisteme rregullatore ose kontraktuale te ndryshme;
- shfrytezim i filialeve te perkohshem (kantiere operues).



Ne rastet e Shoqerive qe sigurojne sherbime, nese filialet ku zhvillohen aktivitetet i nenshtrohen nje certifikimi, nuk jane gati per tu paraqitur per certifikim njekohesisht, Shoqeria duhet te informoje paraprakisht RINA-n per filialet e saj qe deshirojne te perfshihen ne certifikim dhe per ato qe duhet te perjashtohen.

### 8.3

Mbi bazen e informacioneve te dhena nga Shoqeria, RINA percakton planin e modelit aplikues.

Ky aktivitet, ne pergjithesi, kryhet pergjate procesit te kontrollit por mund te kryhet edhe pasi te kete mbaruar kontrolli ne qendren kryesore. Ne cdo rast RINA informon zyren qendrore mbi filialet qe do te jene pjese e modelit.

### 8.4

RINA leshon vetem nje certifikate me emrin dhe adresen e filialit qendror te Shoqerise. Ne nje anex bashkelidhur, ose ne certifikate, eshte lista e te gjithe filialeve te cileve i referohet certifikata.

Shoqerise mund ti leshohet nje certifikate ekstrakt per secilin filial qe mbulon certifikimi, me kusht qe ato te permbajne te njejten fushe apo nje nen-element te tyre qe permban referim te qarte me certifikaten kryesore.

### 8.5

Per mosperputhje/verejtje te mundshme perkatese vetem te njerit filial pergjate kontrollit, Shoqeria duhet te vleresoje nese, po te njejtat shkelje jane edhe ne filialet e tjere, dhe ne kete rast, duhet te ndermarre veprime korigjuese si ne filialin qendror ashtu edhe ne filialet e tjere.

Nese, mosperputhjet dhe/ose verejtjet nuk rezultojne te jene te llojit te lartpermendur, Shoqeria duhet te jape evidencat e duhura dhe arsyet kufizimin e veprimeve te saj korigjuese te metejshme.

Nese gjenden mosperputhje edhe ne nje filial te vetem, gjithë certifikimi pezullohet ne te gjithë rrjetin e filialeve te listuar, deri kur keto mosperputhje nuk jane korigjuar dhe me marreveshje sic parashikohet ne piken 10.1.

Nuk eshte e pranueshme qe, per te hequr objektin qe krijon ekzistenca e nje mosperputhjeje te nje lloji te vetem, te nje filiali te vetem, Shoqeria te perjashtoje nga kjo fushe kete filial/e pergjate vijimit te procesit te certifikimit.

**8.6**

Shoqeria duhet te mbaje te informuar RINA-n mbi mbylljen e cfaredo filiali qe mbulon certifikimi. Nese keto informacione nuk komunikohen, RINA mund te vleresoje nese duhet te procedoje ne perputhje me sa eshte parashikuar ne piken 10.1.

Ne nje certifikim ekzistues mund te futen edhe filiale te tjere duke u ndjekur nga nje kontroll mbikeqyres apo ricertifikues dhe sipas shtrirjes te fushes se certifikimit.

**KAPITULLI 9****TRANSFERIMI I CERTIFIKATAVE TE AKREDITUARA****9.1**

Nese nje Shoqeri ka nje certifikate te vlefshme, te leshuar nga nje tjetër Organizem i Certifikimit te Sistemit, te akredituar nga Organi i Akreditimit qe bashkohet me marreveshjen e njohjes reciproke IAF MLA, do te transferoje certifikimin e saj tek RINA, duhet ti dergoje RINA-s "Pyetesorin Informues" si ne piken 3.1 duke saktësuar arsyet e kerkeses se transferimit.

Shoqeria, ne rast se pranon oferten ekonomike, duhet te dergoje tek RINA "Kerkesen per certifikim" bashkelidhur me dokumentet e meposhtme:

- Kopjen e Cerifikates se vlefshme te leshuar nga nje Organizem i Certifikimit te Sistemit te Menaxhimit Mjedisor te akredituar nga nje Organ Akreditimi nenshkruer i marreveshjeve te njohjes reciproke IAF MLA;
- Kopjen e raportit te kontrollit te certifikimit osete kontrollit te fundit te ricertifikimit dhe raporte te tjera te kontrolleve mbikeqyrese pasuese;
- Kopjen e kontrollit te fundit nga Drejtoria.

Shoqeria duhet pervec te tjerash ti komunikojë RINA-s:

- Vezhgime te mundshme apo sinjalizime nga autoritete kombetare ose rajonale
- Reklamime te mundshme te bera dhe ndermarrjen e veprimeve perkatese

Dokumentacioni i mesiperem ekzaminohet per te verifikuar nese fusha e certifikimit perfshihet ne fushat per te cilat RINA eshte akredituar, vlefshmeria e certifikimit te leshuar nga Organizmi i meparshem i certifikimit ka mbyllur te gjithë Mosperputhjet e mundshme.



Ne rastet kur certifikimi i leshuar nga nje Organizem i meparshem i certifikimit eshte pezulluar, apo nuk eshte i mundshem verifikimi i vlefshmerise se certifikates, ky certifikim nuk mund te pranohet ne proceduren e transferimit.

Verifikimet e mesiperme perfshijne normalisht nje vizite ne Shoqerine e cila ka kerkuar transferimin e certifikimit.

Kontrata midis RINA-s dhe kerkuesit menaxhohet ne te njejtat menyra si ato ne paragrafin 3.1, ne funksion te shtrirjes se aktivitetit te kontrollit.

Pas plotesimit me rezultat pozitiv te aktiviteve te mesiperme, leshohet, per Sistemin e Menaxhimit Mjedisor ne kontroll, nje Certificate ne Perputhje qe, rregullisht, permban skadencen te percaktuar tashme nga Organizmi qe ka leshuar certifikimin e meparshem.

Ne pergjithesi, edhe per kryerjen e kontrollit mbikeqyres e te ricertifikimit te Sistemit eshte mbajtur programi tashme i percaktuar nga Organizmi qe ka leshuar certifikimin e meparshem.

## **KAPITULLI 10 PEZULLIMI, RIVENDOSJA DHE HEQJA E CERTIFIKIMIT**

### **10.1**

Vlefshmeria e certifikates perputhese mund te pezullohet ne pajtim me sa eshte parashikuar ne "KUSHTET E PERGJITHSHME TE KONTRATES PER CERTIFIKIMIN E SISTEMEVE, PRODUKTEVE DHE PERSONELIT" ne rastet specifike te meposhtme:

- nese Shoqeria nuk ka lejuar kontrollet e programuara sipas kerkesave frekvente;
- nese jane gjetur ne Sistemin e Menaxhimit Mjedisor mosperputhje te renda te cilat nuk jane zgjidhur brenda kohes se percaktuar nga RINA;
- nese Shoqeria nuk ka respektuar termat e duhura per komunikimin e veprimeve korrigjuese, per mosperputhjet/verejtjet e sinjalizuara ne raportin e kontrollit;
- nese Shoqeria ka kryer ristrukturime te brendshme ne filialin/et, qe transferohet ne nje tjeter filial/e pa sinjalizuar kete variant tek RINA;
- nese Shoqeria ka kryer ne Sistemin e saj te Menaxhimit Mjedisor modifikime domethenese te cilat nuk jane pranuar nga RINA;
- ne prani te ristrukturimeve te rendesishme te Shoqerise te cilat nuk i jane komunikuar RINA-s;



- nese refuzon apo pengon pjesmarrjen e kontrollit mbikeqyres te nje Enti te Akreditimit;
- nese evidentohet qe Sistemi i Menaxhimit Mjedisor nuk garanton respektin e ligjeve dhe rregulloreve te aplikueshme per aktivitetin dhe/ose te filialit/eve;
- gjetja e justifikimeve te mundshme dhe reklamimeve te renda te ardhura tek RINA;
- 

Shoqeria pervec te tjerash mund ti kerkoje RINA-s, duke justifikuar motivet, pezullimin e certifikimit per nje periudhe ne pergjithesi jo me te madhe se gjashte muaj dhe gjithashtu jo me tej dates se skadences se certifikates.

Pezullimi njoftohet ne leter te shkruar, duke precizuar kushtet per rimarrjen e certifikimit dhe kohet brenda te ciles duhet te jete kryer.

Pezullimi i vlefshmerise se Certifikates hyn ne fuqi nga data e dergimit te njoftimit dhe behet publike zyrtarisht nga RINA drejtperdrejt ne faqen e internetit [www.rina.org](http://www.rina.org) sic eshte parashikuar ne piken 6.3.

## 10.2

Rimarrja e certifikimit varet nga qartesia e eliminimit te shkaqeve qe shkaktuan vete pezullimin me ndermjetesimin e nje kontrolli te thelle qe do te verifikojte nese Sistemi i Menaxhimit Mjedisor ploteson te gjithe kerkesat e Standartit referues.

Kjo i njoftohet me shkrim Shoqerise dhe behet publike nga RINA nepermjet faqes se saj te internetit [www.rina.org](http://www.rina.org) sic eshte parashikuar ne piken 6.3.

## 10.3

Mospermbushja e kushteve brenda kohes se percaktuar, si ne piken 10.2 shkakton heqjen e Certifikates ne Perputhje .

Heqja e certifikates ne perputhje mund te vendoset ne pajtim me sa eshte parashikuar ne "KUSHTET E PERGJITHSHME TE KONTRATES PER CERTIFIKIMIN E SISTEMEVE, PRODUKTEVE DHE PERSONELIT" ne rastet specifike te meposhtme:

- kur gjenden arsye, si ato te parashikuara ne piken 10.1 per pezullimin, te cilat gjykohen vecanerisht serioze;
- nese Shoqeria pezullon aktivitetet e saj apo sherbimet te cilat jane objekt i Sistemit te Menaxhimit Mjedisor te certifikuara per nje periudhe me shume se gjashte muaj ne pergjithesi;



- Nese Shoqeria nuk pranon kushtet e reja ekonomike te percaktuara nga RINA per modifikime te mundshme te kontrates;
- Ne rastet e shoqerive shume-filialeshe, nese filiali qendror apo nje nga filialet nuk respekton kriteret e nevojshme per mirembajtjen e certifikates;
- Per cdo motiv tjeter serioz, sipas gjykimit te RINA-s si per shembull, nje cilesi jo e mire, prove e paaftesise se sistemit ne ndjekjen e objektivave te qarta ne respekt te ligjeve ne fuqi e kontraktuale apo te sigurise se produktit.

Heqja e Certifikates ne Perputhje i njoftohet me shkrim Shoqerise dhe behet publike nga RINA sic eshte parashikuar ne piken 6.3.

Shoqeria qe pas heqjes se certifikates, deshiron te certifikohet perseri, duhet te paraqese nje kerkese te re duke ndjekur te gjitha procedurat.

## **KAPITULLI 11 DOREHEQJA NGA CERTIFIKIMI**

Shoqeria e certifikuar mund te dergoje nje komunikim formalte doreheqjes se certifikimit tek RINA, perpara skadences se Certifikates, perfshire rastin ne te cilin vete Shoqeria nuk deshiron apo nuk mund tu pershtatet instruksioneve te reja te dhena nga RINA.

RINA, ne momentin e marrjes se komunikimeve te tilla, nis procedurat e nevojshme per ta bere certifikaten te pavlefshme.

Ne pergjithesi, brenda nje muaji nga data e marrjes se komunikimit, RINA ploteson gjendjen e vlefshmerise se certifikates.

## **KAPITULLI 12 KUSHTET KONTRAKTUALE**

Per kushtet kontraktuale, gjen aplikim permbajtja e dokumentit te RINA-s "KUSHTET E PERGJITHSHME TE KONTRATES PER CERTIFIKIMIN E SISTEMEVE, PRODUKTEVE DHE PERSONELIT", ne botimin ne fuqi.

Publikim: RC/C 36  
Botim Italian

RINA  
Via Corsica, 12 - 16128 Genova - Italia  
Tel. +39 01053851 - Fax: +39 0105351000  
[www.rina.org](http://www.rina.org)

---

Regullore teknike